



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 54, Datë 22.02.2021

MBI  
LICENCIMIN E SHOQËRISË “GERTI” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e” dhe nenit 13, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 22.02.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 30/3 prot., datë 16.02.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 11, datë 20.01.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje me “Njoftimin për Licencim” nr. 6/6 prot., datë 20.01.2021, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “GERTI” sh.p.k.
- Me shkresën nr. 264 prot., datë 01.02.2021, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe i komunikoi detyrimin për plotësimin e dokumentacionit të munguar të pasqyruar në vendimin e fillimit të procedurës.
- Shoqëria “GERTI” sh.p.k., në përgjigje të sa më sipër me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 264/1 prot., datë 10.02.2021 dhe atë nr. 5/1 prot., datë 11.02.2021, ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën përfundimtare të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “GERTI” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson tërësisht kërkesat e *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, si më poshtë:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”, **plotësuar.**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, **plotësuar.**
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, **plotësuar.**
  - **Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike**, Neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b”, “c”, **plotësuar.**

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “GERTI” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**